




**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**



**V E N D I M
Nr. 35, date 20.5.2019**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË KONSOLIDUAR TË ZBATIMIT
TË BUXHETIT TË VITIT 2018 TË BASHKISË SHKODËR**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 20.5.2019, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 51 e vijues të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të ndryshuar, Udhëzimin e ministrisë së financave dhe ekonomisë nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimin e ministrisë së financave dhe ekonomisë nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin e ministrisë së financave dhe ekonomisë nr. 39, datë 24.12.2018 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2018, Udhëzimin e ministrisë së financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për miratimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar, VKB nr. 26, datë 18.4.2019 “Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2018 të bashkisë Shkodër, nenin 55 pika 2 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“,

V E N D O S I :

1. Miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2018 të bashkisë Shkodër, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 20.5.2019

Shpallur në datën 22.5.2019

Sekretar i këshillit

Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI